

VENDIM
Nr.35, datë 22.7. 2005

**PËR DHËNIEN E LICENCËS SË FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR SHOQERISË DARFO
ALBANIA SHPK, PËR FURNIZIMIN DHE TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
KLIENTIN E KUALIFIKUAR DARFO ALBANIA SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, germa ç; 15 pika 1 dhe 45 pika 2 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 “Rregullorja për procedurat e licencimit”, neni 5 pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.7.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Darfo Albania” sh.p.k., për marrje të licencës Së furnizuesit të kualifikuar për aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, vetëm për plotësimin e nevojave të furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k.

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës së furnizuesit të kualifikuar shoqërisë “Darfo Albania” sh.p.k., për aktivitetin e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, vetëm për plotësimin e nevojave të furnizimit me energji elektrike të klientit të kualifikuar “Darfo Albania” sh.p.k., për periudhën deri më 31.12.2006.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema